

LIGJI NR. 08/L-113**PËR POLICINË USHTARAKE NË FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të Nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR POLICINË USHTARAKE NË FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS**Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj përcakton misionin, organizimin, autorizimet dhe detyrat e Policisë Ushtarake në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky ligj zbatohet ndaj të gjitha subjekteve ushtarake dhe civile, vendore dhe të huaja, me ose pa shtetësi, të cilat me veprimet e tyre cenojnë veprimtarinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës brenda dhe jashtë vendit.

**Neni 3
Juridiksioni**

Policia Ushtarake e ushtron juridiksionin e saj në territorin e Republikës së Kosovës, si dhe kur dërgohet me mision jashtë vendit në mbështetje të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

**Neni 4
Përkufizimet**

1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1.1. **Policia ushtarake** (PU) është Policia e Forcës së Sigurisë së Kosovës;

1.2. **Pjesëtar i Policisë Ushtarake** - pjesëtari i FSK-së që është përzgjedhur dhe emëruar të kryejë detyra të PU-së;

1.3. **Informacion** - është çdo njohuri që mund të komunikohet apo të dokumentohet, pavarësisht nga forma;

1.4. **Përdorimi i forcës** - është veprimi i drejtpërdrejtë i pjesëtarit të Policisë Ushtarake nëpërmjet forcës fizike, pajisjeve apo mjeteve të tjera të dhëna në përdorim në bazë dhe për zbatim të ligjit, në mënyrë të arsyeshme dhe proporcionale;

1.5. **Shoqërimi** - është dërgimi i personit në ambientet e Policisë Ushtarake apo vende të tjera të caktuara nga organet kompetente, me ose pa vullnetin e tij, për shkaqe të parashikuara në këtë ligj;

1.6. **Veprimtari informative** - është veprimtaria e pjesëtarit të Policisë Ushtarake, e kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi për kërkimin, gjetjen, grumbullimin, regjistrimin,

administrimin, verifikimin, analizimin e të dhënave dhe informacioneve për veprimtari të kundërligjshme në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

2. Përkufizimet tjera të përdorura kanë kuptim sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5 Misioni

Policia Ushtarake ka për mision ruajtjen e rendit ushtarak dhe garantimin e zbatimit të ligjit në Forcën e Sigurisë së Kosovës, mbrojtjen e jetës së personelit, mbrojtën e pronës shtetërore në përdorim apo administrim të Forcës së Sigurisë së Kosovës, brenda dhe jashtë vendit.

Neni 6 Parimet

1. Policia Ushtarake veprimtarinë e saj e realizon mbi parimet e:

- 1.1. ligjshmërisë;
- 1.2. respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- 1.3. proporcionalitetit;
- 1.4. pavarësisë së hetimeve dhe operacioneve;
- 1.5. profesionalizimit;
- 1.6. paanësisë;
- 1.7. objektivitetit;
- 1.8. integritetit;
- 1.9. mos-diskriminimit;
- 1.10. transparencës;
- 1.11. kontrollit; dhe
- 1.12. llogaridhënies.

Neni 7 Statusi

Policia Ushtarake është strukturë e specializuar në përbërje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në varësi të Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Neni 8 Autorizimet

1. PU-ja i ushtron autorizimet e veta në kazermat apo në zonat e operacionit ku operon FSK-ja, në hapësirat e MM-së, jashtë kazermave ndaj personelit të FSK-së dhe MM-së, si dhe ndaj personave që bien ndesh me urdhrat e ligjshëm të PU.

2. Policia Ushtarake për përmbushjen e misionit të saj, mbështetet në dispozitat e këtij ligji, Ligjit për Statusin, Imunitetet dhe Privilegjet e Misioneve Diplommatike dhe Konsullore dhe personelin në Republikën e Kosovës dhe Praninë Ndërkombëtare Ushtarake dhe personelin e

saj, si dhe legjislacionin tjetër në fuqi, dhe ka këto autorizime:

- 2.1. të kryejë kontrolle të sigurisë, përfshirë por jo kufizuar vetëm në: kontrollin e personave, dokumenteve, mjeteve të transportit, bagazheve, objekteve dhe hapësirave;
- 2.2. të rregullojë trafikun dhe të shqiptojë gjoba të trafikut sipas legjislacionit në fuqi, për pjesëtarët e FSK dhe personelin e MM në automjete zyrtare;
- 2.3. të rregullojë trafikun dhe të shqiptojë gjoba të trafikut sipas legjislacionit në fuqi brenda kazermave të FSK;
- 2.4. të përdorë sinjalistikën emergjente për lëvizje në trafik;
- 2.5. të kufizojë lëvizjen, të ndalojë, të arrestojë dhe të shoqërojë persona;
- 2.6. të përdorë forcën dhe mjete shtrënguese të domosdoshme dhe proporcionale sipas legjislacionit në fuqi;
- 2.7. të identifikojë dhe të verifikojë persona, mjetet dhe pajisjet;
- 2.8. të bëjë identifikimin e personave të cilët përdorin apo bartin uniformë, pjesë të uniformës, shenja, simbole apo mjete të ngjashme me ato të FSK-së;
- 2.9. të mbledhë, vlerësojë, ruajë dhe të procedojë të dhëna dhe informacione lidhur me shkeljet e dyshuara;
- 2.10. të kryejë veprime për parandalimin dhe hetimin e veprimeve kundërligjore, sipas procedurave të parapara me legjislacionin në fuqi;
- 2.11. të bëjë sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, mjeteve dhe pajisjeve në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- 2.12. të bëjë sigurimin e sendeve, objekteve, lokacioneve, zonave, vendngjarjes, provave dhe dëshmive;
- 2.13. të bëjë mbrojtjen e personave, objekteve, dhe zonave me rëndësi të veçantë;
- 2.14. të bashkëpunojë me Policinë e Kosovës dhe agjencitë tjera të zbatimit të ligjit dhe sigurisë;
- 2.15. të kryejë detyra të tjera në kuadër të misionit të FSK-së, konform urdhërësave të marra nga zinxhiri komandues;
- 2.16. të përdorë pronën e personave të tretë në rrethana emergjente dhe jashtëzakonshme.

Neni 9

Detyrat e Policisë Ushtarake

1. PU-ja ka për detyrë të:

- 1.1. mbajë rendin dhe disiplinën ushtarake në FSK;
- 1.2. sigurojë mbarëvajtjen e trafikut ushtarak;
- 1.3. parandalojë, hetojë dhe zbulojë krimet të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare, të kryera nga pjesëtarët e FSK dhe punonjës të tjerë të FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes, brenda objekteve ushtarake apo që lidhen me aktivitetet ushtarake, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- 1.4. mbrojë personelin, delegacionet dhe personat me rëndësi të veçantë;
- 1.5. mbrojë pronën, komandën dhe njësitë ushtarake;
- 1.6. mbrojë objektet ose zonat me rëndësi të veçantë.

Nenin 10

Organizimi i Policisë Ushtarake

1. Policia Ushtarake në Forcën e Sigurisë së Kosovës është e organizuar në:

- 1.1. Komanda e PU-së, e cila siguron komandim dhe kontroll ndaj Policisë Ushtarake. Komanda përbëhet nga stafi komandues dhe sektorët funksionalë për të mbështetur operacionet e Policisë Ushtarake;
- 1.2. Njësia e mbrojtjes së afërt që ofron siguri dhe përcjellje për personalitetet e rëndësishme, gjatë kryerjes së aktiviteteve zyrtare;
- 1.3. Njësia për rend ushtarak e cila siguron dhe kontrollon zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore për rendin dhe disiplinën ushtarake në kuadrin e veprimtarisë së FSK-së;
- 1.4. Njësia e hetimeve për parandalimin, zbulimin, ndjekjen e veprimtarisë kriminale, kapjen e personave që kanë kryer ose përgatiten të kryejnë vepra penale brenda hapësirave që janë nën administrimin dhe menaxhimin e FSK-së dhe MM-së.

2. Njësia e hetimeve nga nën-paragrafi 1.4. i këtij neni, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, për shkeljet të cilat janë të parapara në Kodin Disiplinor dhe aktet tjera normative të FSK-së, vepron në bashkëpunim me njësitë e FSK-së, kurse për kundërvajtjet dhe veprat penale, bashkëpunon me Policinë e Kosovës, Gjykatat dhe Prokurorinë.

3. Policisë Ushtarake mund t'i shtohen edhe njësi tjera të specializuara dhe operationale, varësisht nga nevojat e FSK-së.

Neni 11

Paraqitja e kallëzimit penal

Hetuesi i Policisë Ushtarake paraqet kallëzim penal për veprat që cenojnë ose mund të cenojnë Forcën e Sigurisë së Kosovës, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Hetuesi vendos dokumentacionin përkatës në dispozicion të prokurorit që ka në kompetencë ushtrimin e ndjekjes penale.

Neni 12**Njoftimi për paraqitje në Policinë Ushtarake**

1. Ushtaraku ose civili që punon në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrinë e Mbrojtjes, ftohet për t'u paraqitur në zyrat e njësive se hetimeve të PU-së si i dyshuar, dëshmitar apo që ka informacione për raste penale apo disiplinore.
2. Njoftimi për paraqitje bëhet me anë të fletë-thirrjes, email-it zyrtar, telefonit, duke përcaktuar arsyen e paraqitjes, kohën, vendin, si dhe punonjësin e Policisë Ushtarake që e ka ftuar.

Neni 13**Shoqërimi në Policinë Ushtarake**

1. Polici Ushtarak shoqëron në zyrat e Policisë Ushtarake, në lokacione të caktuara, pjesëtarët e uniformuar dhe civilët në të gjitha rastet që:
 - 1.1. refuzojnë të paraqesin dokumentin e identifikimit apo dyshohet për vërtetësinë e tij;
 - 1.2. kundërshtojnë ose pengojnë pjesëtarin e Policisë Ushtarake në kryerjen e detyrës;
 - 1.3. janë gjetur në vendngjarje dhe për të cilët dyshohet se janë autorë të veprës penale;
 - 1.4. kërkohen nga organet e drejtësisë.
2. Personi që shoqërohet nga Policia Ushtarake, i krijohen kushte normale qëndrimi sipas legjislacionit në fuqi dhe pas sqarimit të rrethanave të çështjes për të cilën është shoqëruar, kur nuk është i përfshirë, i ndërpritet shoqërimi. Në rast se personi është i përfshirë vepërohet sipas nenit 14 të këtij ligji.
3. Kur Policia Ushtarake kap një civil në strukturë ose zonë me rëndësi të veçantë, zonë ushtarake, në vend ngjarje i dyshuar për veprë penale, në zmbarsje të sulmit ndaj ekipit, personave ose sendeve dhe pasurive që ka në mbrojtje, do të informojë Policinë e Kosovës.
4. Kundër personit nga paragrafi 3. i këtij neni, Policia Ushtarake mund të përdorë masat e nevojshme dhe mjetet shtrënguese, duke e ndaluar deri në ardhjen e Policisë së Kosovës.
5. Në të gjitha rastet, personi i shoqëruar apo i ndaluar nuk mund të mbahet më shumë se gjashtë (6) orë.

Neni 14**Arrestimi dhe ndalimi**

Polici Ushtarak bën arrestimin dhe ndalimin e ushtarakut dhe civilit sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 15**Përdorimi i forcës dhe armëve të zjarrit**

Policia Ushtarake është e autorizuar ta përdorë forcën, armët e zjarrit, mjetet dhe pajisjet që i ka në përdorim, në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë, me qëllim të përmbushjes së autorizimeve dhe detyrave sipas legjislacionit në fuqi. Në zbatim të këtij neni Ministri i Ministrisë së Mbrojtjes nxjerr akt nënligjor.

Neni 16**Uniformat, shenjat dhe simbolet e Policisë Ushtarake**

1. Policia Ushtarake, gjatë kryerjes së detyrave dhe autorizimeve të saj, përveç uniformës zyrtare mund të veshë edhe rroba civile.

2. Polici Ushtarak pajiset dhe mban dokument identifikimi të Policisë Ushtarake me numër identifikues (distinktivin), dhe-identifikohet në rast se kërkohet.

Neni 17

Mjetet lëvizëse të Policisë Ushtarake

Në ushtrimin e detyrave, PU përdor mjete ushtarake dhe civile. PU mund të përdorë automjete me përparësi kalimi (sisteme alarmi dhe drita rotative) dhe mjete shoqërimi. Varësisht nga misioni dhe detyra mund të përdorën automjetet nga ato transportuese, luftarake dhe automjete speciale për detyra specifike të PU-së.

Neni 18

Trajnimi profesional i Policisë Ushtarake

1. PU i nënshtrohet trajnimit profesional nga institucionet arsimore të FSK-së ose jashtë tyre, të cilat ofrojnë trajnim në përputhje me ligjin.

2. Për ushtrimin e detyrave dhe autorizimeve pjesëtari, i PU-së duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve të brendshme të përcaktuar nga FSK-ja dhe legjislacioni përkatës në fuqi.

3. Pjesëtari i Policisë Ushtarake ricertifikohet çdo pesë (5) vite, në mënyrën e përcaktuar nga FSK-ja dhe legjislacioni përkatës në fuqi. Dështimi në ricertifikim, nënkupton humbjen e statusit të PU-së, por jo edhe shërbimin në FSK.

Neni 19

Rrezikshmëria

PU-ja gëzon të drejtën për pagesën e rrezikshmërisë sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 20

Shkëmbimi i informacionit

Policia Ushtarake shkëmben informacione me Policinë e Kosovës dhe Agjencitë tjera të zbatimit të ligjit dhe sigurisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 21

Detyrimi për të mos dhënë informacion

1. Polici Ushtarak dhe zyrtarët e tjerë që punojnë në Policinë Ushtarake nuk duhet të japin informacione, për të cilat kanë marrë dijeni gjatë kryerjes së detyrës ose jashtë saj, përveç personave të autorizuar me ligj.

2. Detyrimi për të mos dhënë informacion zbatohet edhe për policin ushtarak të liruar ose të larguar nga Policia Ushtarake.

3. Për informacione, që kanë të bëjnë me identitetin e dëshmitarëve dhe sinjalizuesve, Policia Ushtarake zbaton legjislacionin në fuqi.

Neni 22

Aktet nënligjore

1. Në zbatim të neneve 8, 9, 13 dhe 15 të këtij ligji, Ministri i Mbrojtjes nxjerr akte nënligjore të veçanta, në afat prej dymbëdhjetë (12) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Aktet nënligjore që janë në fuqi vazhdojnë të zbatohen, deri në nxjerrjen e akteve të reja, me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 23
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen të gjitha aktet nënligjore që janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-113
19 maj 2022

Shpallur me dekretin Nr. DL-161/2022, datë 03.06.2022 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu